



KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA - MUNICIPALITY OF VITI

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI.

TETOR 2024



Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (AQP), në komunën e Vitisë përkatësisht në Drejtorinë e Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi (DKPGJ) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), ka identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimit është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengojë gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Vitisë me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori më datën 03 Tetor 2024, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Rahovecit dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastër, Grupi II-Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DKPGJ.

Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

AQP në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Vitisë në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DKPGJ Viti, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
QeK	Qeveria e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
LK	Ligji për Kadastër
LKPP	Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
SIK	Sistemi i Intranetit të Komunës
ZIP	Zyra për Informim të Publikut
DPGJK	Zyra Kadastrale e Komunës
ZKM	Zyra e Kryeministrit

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA VITI

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Ri-organizimi i punës në sportel	1	Dorëzimi i të gjitha llojeve të lëndëve të bëhet në sportel	Vendimi nga Drejtoresha e ZKK-së	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
		2	Ndarja fizike me xhama	Kërkesa tek Drejtoria e Administratës dhe ajo e Financave për sigurimin e mjeteve dhe aktivitetet e prokurimit, sigurimi i tavolinave dhe karrigeve për palë	ZKK, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave	1000 Euro	Q1 2025	Mungesa e buxhetit
		3	Të realizohet kontrolli fillestar i lëndës së dorëzuar	Vendimi nga Drejtoresha e ZKK-së	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
		4	Të bëhet lëshimi i certifikatave të pronësisë, kopjeve të planit dhe koordinatave të njësive kadastrale në sportel	Vendimi nga Drejtoresha e ZKK-së	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
		5	Vendosja e monitorit në pjesën e sportelit	Blerja e monitorit	ZKK, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave	400 Euro	Q1 2025	Mungesa e buxhetit
		6	Në sportel të vendosen fletëpalosje dhe lista e dokumentacionit të nevojshëm për secilën lëndë	Printimi i fletëpalosjeve dhe udhëzuesit e ri nga AKK	AKK, ZKK dhe PGA	3000 Euro	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe
2	Orari me palë	1	Të caktohet orari me palë për gjeodetë dhe kompani gjeodete të licencuara	Vendimi nga Drejtoresha e ZKK-së, vendosja e njoftimit në ZKK	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
3	Mungesa e skanerit dhe printerëve	1	Sigurimi i një printeri dhe skaneri të madh nga kompania e kontraktuar nga AQP, si dhe mirëmbajtja e printerit dhe skanerit dhe një printeri të vogël në sportel	Kërkesa nga ZKK tek Drejtoria e Administratës	ZKK dhe Drejtoria e Administratës	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Mos përgjegjësia nga Kompania e kontraktuar nga AQP

PJESA LIGJORE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Komunikimi me palët në rast të mungesës së dokumentacionit	Të pezullohen kërkesat dhe të lëshohen me shkrim për palët kërkesat për kompletim të dokumentacionit	Pezullimi i kërkesave në SIKTK dhe plotësimi dhe dërgimi me postë (ose email)	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
2	Vendimet lëshohen vetëm në gjuhën shqipe	Rekomandohet që vendimet të lëshohen në gjuhën në të cilën është plotësuar formulari i kërkesës	Të lëshohen vendimet edhe në gjuhën serbe	ZKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Nuk parashihen rreziqe
3	Hapësira për numra të tjerë të telefonit	Të kërkohet nga AKK, që në të lejohej në SIKTK shënimi i numrave të telefonit të qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës	Ndryshime në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë	AKK	Nuk ka ndikime buxhetore	Q4 2024	Pamundësia e dërgimit automatik të SMS nga SIKTK tek operatorët mobil ndërkombëtar

PËRFSHIRJE GJINORE DHE SOCIALE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	<p>Të shqyrtohen masa afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të pronës së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe duhet të plotësohet me masa afirmative shtesë për të përfshirë nënat vetushqyese dhe grupet e tjera te cenueshme.</p>	<p>Zyrtarët komunalë të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, përfshirë edhe komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian.</p> <p>Agjencia për Barazi Gjinore ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjeroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cenueshme).</p>	<p>Organizimi i takimeve informuese, tryezave, fushatave vetëdijësuese me gra, burra, vajza e djem për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të organizohet fushatë informuese në rrjete sociale për sensibilizim për të drejtat e grave. Të bëhet krijimi i një platforme online për aplikim dhe informim në webfaqe zyrtare të komunës.</p> <p>Agjencia për Barazi Gjinore të konsultohet me Agjencinë Kadastrale, komunat dhe OJQ-të që të zgjerojnë masën afirmative (nënat vetushqyese, gratë e veja, gratë në gjendje të cenueshme shëndetësore), dhe të bëjnë të përhershme masën afirmative.</p>	<p>Zyra për Barazi Gjinore, Kryetarët e Këshillave Lokal, Grupet e Grave, OJQ-të, Agjencia për Barazi Gjinore dhe Agjencia Kadastrale.</p>	<p>5,000 Euro</p>	<p>Ky aktivitet duhet të bëhet në vazhdimësi, duke filluar nga Marsi 2025.</p>	<p>Mungesa e buxhetit/buxheti i limituar për implementimin e aktiviteteve.</p>
2	<p>Duhet te krijohen masa dhe të ndermirën veprime të veçanta për mbështetjen e grave, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal, me qëllim të fuqizimit social.</p>	<p>Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja dhe atyre ekzistuese. Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të pajisjeve prodhuese dhe përpunuese, në fushën e bujqësisë subvencionimin në agrikulturë; Të shikohen mundësitë e prioritizimit (gjatë poentimit) të aplikantëve të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve, nënat vetushqyese, gjatë ndarjes se granteve dhe subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë.</p>	<p>Planifikimi i hershëm i buxhetit në baza vjetore nga DEFZH, mbi parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Të zbatohet LBGJ dhe masat e veçanta në implementimin e ndarjes së subvencioneve në komunë. Të thjeshtëzohen procedurat dhe dokumentacionet e nevojshme për aplikim për subvencione. Të organizohen sesionet informuese për plotësimin e dokumentacionit (psh përgatitja e biznes planit dhe dokumenteve përcjellëse).</p>	<p>DEFZH, Komisioni Për Subvencione Komunale, Komisione Monitoruese.</p>	<p>40,000 Euro me rritje eksponenciale në baza vjetore</p>	<p>Të fillohet me planifikim në hkur, ndërsa me hapa konkret në planifikim në mars deri në muajin nëntor.</p>	<p>Mungesa e buxhetit, mungesa e vullnetit politik.</p>

3	Ngritja e vetëdijes për qasjen e grave në trashëgimi.	Informata rreth legjislacionit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cenueshme të bëhen nga zyrtarët komunal në bashkëpunim me OJQ-të. Zyrtarët duhen të trajnohen për çështjet e qasjes së grave në pronë. Ngritja e vetëdijes të burrave për të drejtat pronësore të grave. Të bëhet vetëdijesimi i komunitetit në tërësi që të gjithë të jenë të informuar për të drejtat pronësore të grave.	Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunalë që të ndërmarrin fushata vetëdijësuese, me theks te veçantë në viset rurale dhe vendbanimet e komuniteteve. Organizimi i fushatës vetëdijësuese: -Tryezë diskutimi me akterë të ndryshëm, -Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese, faqe te komunës, rrjete sociale etj. -Organizimi i takimeve informuese me qytetarët ne qytet dhe vende rurale përmes përfaqësueseve të këshillave lokale.	Zyra për Barazi Gjinore, Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër, Zyra e Regjistrimit Civil, Zyra për Informim, Kryetarët e Këshillave lokale, Grupet e Grave, OJQ-të.	3,000 Euro	Të fillohet me planifikim të aktivitetit në Mars 2025 dhe me implementim ne Prill e në vazhdimësi.	Rreziku nga mungesa e buxhetit. Sfidë pjesëmarrja e qytetareve.
4	Të ngritet qasja e personave me nevoja të veçanta në shërbimet komunale që lidhen me pronë e kadastër.	Të sigurohet qasja për personat me të pamur të dëmtuar dhe me probleme me dëgjim në shërbime komunale kadastrale. Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori.	Të sigurohet interpreti i gjuhës së shenjave dhe qasja në alfabetin e Brajllit për persona me të pamur dhe me dëgjim të dëmtuar.	Zyra e Kryetarit, Zyra e Burimeve Njerëzore, DEFZH, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe për Barazi Gjinore.	10,000 Euro	Të fillohet me planifikim në shkurt të vitit 2025, ndërsa lobimi për ndarje të mjeteve të filloj në maj me kornizë afatmesme buxhetore.	Mungesa e buxhetit, mungesa e interpretëve, mungesa e profesionistëve të fushës për interpretimin e sistemit të Brajllit.
5	Të shqyrtohet mundësia e lirimit nga tatimi në pronë për 50%, për periudhën 2 vjeçare kur me kusht që prona të regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve ose në emër të gruas.	Vendimi nga asambleja komunale për masën afirmative.	Të përgatitet propozimi për asamblenë lidhur me faljen e tatimit në pronë në vlerë 50%, për dy vitet e ardhshme për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe në emër të grave.	Kryetari, Kuvendi Komunal, DEFZH, Zyra e Tatimit në Pronë, Zyrtarja për Barazi Gjinore, MAPL dhe MF.	Të konsultohen zyrat relevante në Komunë për impaktin financiar të kësaj mase.	Fillimi për përgatitje të zbatimit të kësaj mase të bëhet nga marsi 2025, në mënyrë që të përfshihet në rregullore për tatim në pronë në shtator.	Konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL dhe MF. Mungesa e vullnetit politik.